



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

**NR. 3 , DATË 20.01.2023**

**PËR**

**“GARANTIMIN E TË DREJTAVE DHE INTERESAVE TË VIKTIMAVE TË VEPRAVE PENALE GJATË HETIMIT TË KALLËZIMEVE DHE PROCEDIMEVE PENALE”.**

Në mbështetje të neneve 148, 148/b e vijues të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe në neneve 38, 42, 43, 46, 47, 48, 50 e vijues të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.10/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, Urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë me Nr.02, datë 07.01.2021, “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”, në zbatim të Rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit dhe kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm me nr.1682/1 prot, datë 11.01.2023, “Mbi rekomandimin e institucionit të Avokatit të Popullit”;

Në Rekomandimin e institucionit të Avokatit të Popullit me shkresën Nr.K2/I 28-7 Prot, datë 16.12.2022, “Për ndryshimin e praktikës së deritanishme”..., ndër të tjera është kërkuar që:

- *Bashkimi i procedimeve dhe ushtrimi i ndjekjes penale nga i njëjti prokuror, në rastet kur prokuroria, krahas regjistrimit të procedimit penale ndaj shtetasve për kryerjen e veprave penale, njëkohësisht regjistrohen procedim penal dhe mbi bazen e kallëzimit të personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime në atë prokurori, apo mbi bazën e ankimit të tyre në seancë gjyqësore, për dhunim fizik ndaj tyre nga ana e punonjësve të policisë, në momentin e kapjes, shoqërimit në organet e policisë apo gjatë marjes së deklarimeve.*
- *Kjo problematikë lidhet dhe me gjetjet në Raportin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës (CPT) për Shqipërinë, publikuar në datën 17.09.2019, ku sipas vlerësimit të CPT-së, një përgjegjësi e tillë e dyfishtë mund të çënojë paanshmërinë e prokurorit që heton këto raste, ndaj Komiteti ka rekomanduar që rastet e keqtrajtimit të mundshëm të policisë të hetohen nga prokurorë të cilët nuk kanë lidhje me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtuara.*
- *Mosnjoftimi i shtetasve nga prokuroria për mënyrën e trajtimit dhe përfundimit të hetimeve për kallëzimet e paraqitura prej tyre në polici apo në prokurori, megjithëse kanë kaluar*

*muaj apo vite, që ka sjellë mos ushtrim të së drejtës së ankimit nga ana e tyre ndaj akteve përkatëse të prokurorit në gjykatë;*

Për sa më sipër, Avokati Popullit ka rekomanduar ndryshimin e praktikave në zbatim dhe të rekomandimit të Raportit të CPT-së (2019), për ndarjen e procedimeve penale dhe hetimin e tyre nga prokurorë të ndryshëm, në rastet e kallëzimeve/ankesave për keqtrajtim të shtetasve nga punonjësit e policisë, si dhe për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me respektimin e të drejtave të kallëzuesit dhe/ose viktimës.

*Sa më sipër, në respektim të këtij rekomandimi, kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe në kuadër të ushtrimit të detyrës kushtetuese dhe ligjore në prokurori, me qëllim për të siguruar një procedim të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjorë,*

## **UDHËZOJ:**

1. Të gjithë Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në këtë prokurori apo në varësi procedurale të saj, të njihen dhe të zbatojnë Rekomandimin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm, me qëllim rritjen e efektivitetit të hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale me viktime të vepres penale dhe mbrojtjen e interesave të shtetasve apo viktimave në procesin penal.
2. Prokurorët dhe oficerët/agjentët e policisë gjyqësore të të gjitha strukturave dhe niveleve, të garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit në procesin penal.
3. Gjatë pyetjes së të arrestuarit ose të ndaluarit apo personit të shoqëruar, nëse prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore, vëren se ata kanë shenja keqtrajtimi ose ankohen për keqtrajtim nga ana e policisë gjatë arrestimit apo qëndrimit në polici, bëjnë verifikime nevojshme dhe kur konstatojnë keqtrajtime dhe vendosin sipas rastit regjistrimin e procedimit penal si dhe njoftojnë autoritetin përkatës të policisë për keqtrajtimin. Në këto raste, menjëherë të kërkohet dhe të vendoset kryerja e ekspertimit mjeko-ligjor përkatës, duke shmangur çdo pengesë të personave ndaj të cilëve janë bërë pretendimet për keqtrajtime.
4. Në rastet e kallëzimeve/ankesave për keqtrajtim të shtetasve ndaj të cilëve është rregjistruar procedimi penal, prokurorët marrin masa për të shmangur ndjekjen e dy procedimeve nga i njëjti prokuror, duke njoftuar Drejtuesin e Prokurorisë, për të bërë shortimin e veçantë të procedimeve apo nëpërmjet ndarjes së procedimeve në rastet kur dy referime/kallëzime penale ndiqen në kuadrin e një procedimi penal. Kjo, për të siguruar një procedim penal të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, në mbrojtje të të drejtave e lirive personale të shtetasve dhe për të shmangur njëanëshmërinë në hetimin e këtyre çështjeve.
5. Prokurorët, duhet të bëjnë kujdes për të respektuar dispozitat ligjore përkatëse lidhur me njoftimet brenda afatit ligjor, për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, ose pezullimin e hetimeve, si ndaj personit/subjektit që ka bërë kallëzimin penal, ashtu dhe viktimën që ka bërë ankimin/kallëzim, në polici ose në prokurori, për t'i garantuar të drejtën e ankimit kundër vendimit përkatës në gjykatë.

6. Zbatimi i këtyre parashikimeve bëhet me synim për të siguruar një procedim të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor në mbrojtje të interesave të shtetasve apo viktimave në procesin penal, duke garantuar pavarësinë e prokurorëve dhe shmangur çdo rast papërshtatshmërie që lidhet me influencën dhe njënashmërinë e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në hetimin e këtyre çështjeve, si dhe rritjen e besimit të publikut tek organi i prokurorisë.
7. Me këtë udhëzim dhe për zbatimin e tij, të njihen të gjithë Prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve të të gjitha strukturave.
8. Moszbatimi i këtij udhëzimi pasjell përgjegjësi ligjore apo disiplinore sipas rastit.
9. Ky Udhëzim i Përgjithshëm, hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ALBERT MURÇAJ**

